**VENDIM**
**Nr. 390, datë 10.7.2025**

# PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT DHE NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE NË AFËRSI TË RRUGËS BREGDETARE (VLORË–ORIKUM), RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 83/2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë–Orikum), ratifikuar me ligjin nr. 83/2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

**SFD**
Fondi Saudit për Zhvillim
(121)

**Drejtuar:** Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
SH.T. Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Republika e Shqipërisë

**Tel Nr.:** (+35542228405)

**Email:** Sekretariamin @ financa.gov.al

**Lënda:** Zgjatje e datës së mbylljes të Marrëveshjes së Huasë SFD Nr. 4/777 (Projekti për rehabilitimin dhe ndërtimin e objekteve në afërsi të rrugës bregdetare" Vlorë-Orikum".

**Shkëlqesia Juaj,**

Kam kënaqësinë t'iu informoj se në bazë të dispozitave të seksionit **2.04** të Marrëveshjes së Huasë të cituar, Fondi ka vendosur datën **31/12/2026** si datën e re të mbylljes.

**Përshëndetjet më të mira,**

*/Nënshkrimi/*

**Me respekt,**
*/Nënshkrimi/*

**Sultan A. AlMarshad**
**Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 3821 Prot. Tiranë, më 21 / 3 /2024

Lënda: Marrëveshja e huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për zhvillim, për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum)

**FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM**
**P.O. Box 50483, Riyadh, 11523, Kingdom of Saudi Arabia**

Të nderuar Zotërinj,

I referohem Marrëveshjes së Huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për zhvillim,për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum). Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo marrëveshje huaje, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

-shtyrjen deri më 31.12.2026, të afatit të parashikuar sipas nenit 2.04 të Marrëveshjes së Huasë.

*Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, "Për projektin e rehabilitimit dhe ndërtimit të objekteve në afërsi të rrugës bregdetare (Vlorë-Orikum)".*

*Ky ndryshim hyn në fuqi, në datën e njoftimit të palës shqiptare për Fondin Saudit për Zhvillim mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.*

**MINISTËR I FINANCAVE**
**ERVIN METE**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-MINISTRIA E FINANCAVE